



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.05.2023

MBLEDHJA Nr. 28,
Datë 18.05.2023, ora 12:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 18.05.2023, ora 12:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 28 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 15.05.2023
2. Mbi fillimin e procedurës për miratimin e kërkesës së ALPEX sh.a. lidhur me Komitetin e Bursës Shqiptare të Energjisë
3. Mbi disa ndryshime në kontratën tip mbi verifikimin e matësave të energjisë elektrike dhe vulosjen e tyre, të miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 164/2016”
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “PROINFINIT CONSULTING” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike
6. Mbi licencimin e shoqërisë “ERSEKA SOLAR PARK 1” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 20 MW, në zonën e Ersekës, Bashkia Kolonjë, Qarku i Korçës
7. Mbi modifikimin e licencës për prodhimin e energjisë elektrike të shoqërisë “SEKA HYDROPOWER” sh.p.k., miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 146, datë 10.09.2020, i ndryshuar
8. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s 40, datë 10.03.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “LAJTHIZA INVEST” sh.a. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “QAMI 1”, me kapacitet të instaluar 1.730 MW”, i ndryshuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 197, datë 03.08.2022

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI

Petrit AHMETI